# INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA GAP

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

### Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010

Mars 2011

BU & PARTNERS
Audit • Tax • Consulting

Bedri Pejani no.3
10000 Pristine
Kosova
Tel: +38 38 226 942
Fax: + 381 38 226 942

Për Bordin e Drejtorëve të Institutit për studime të avacuara GAP

Raporti i Auditorit të pavarur

Ne kemi audituar pasqyrat financiare dhe të dhënat tjera financiare të konsoliduara për Institutin për studime të avancuara GAP, të gjitha të shprehura në EURO për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2010. Këto pasqyra financiare dhe të dhënat financiare shtesë janë përgjegjësi e menaxhmentit të organizates.

*Përgjegjesia e menaxhmentit për pasqyrat financiare*

Në pajtueshmeri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare. Përgjegjesitë përfshijnë: disenjmin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm i cili është relevant për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga keqinterpretimet materiale - qofshin këto mashtrime apo gabime, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël si dhe kryerja e vlereësimeve kontabël të cilat janë të arsyeshme për rrethanat ekzistuese.

*Përgjegjesia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion lidhur me informatat financiare të lartpërmendura bazuar në auditimin e kryer. Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Këto standarde kërkojnë nga ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme mbi atë nëse format e raportimit nuk paraqesin keqinterpretime materiale. Auditimi kërkon një ekzaminim, mbi bazë të testimit, të dëshmive që lidhen me vlerat e deklaruara dhe shpalosjet ne format e raportimit. Auditimi gjithashtu përfshin edhe principet kontabël që përdoren dhe vlerësimet e rëndësishme që kryhen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e duhur kontabël dhe raportimin e të dhënave në pasqyrat financiare. Besojmë se auditimi ynë ofron bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

*Opinioni*
Sipas opinionit tonë, informatat financiare të organizatës paraqësin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare vjetore të Institutit të Studimeve të Avancuara GAP deri më datën 31 dhjetor 2010 dhe rezultatet e operacioneve në pajtueshmëri me SNK dhe Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

BU & Partners

Auditor Ligjor
21 mars 2011

BU & PARTNERS PRISHTINË

## Përmbajtja


**Bilanci i gjendjes** ........ 4
**Pasqyra e të ardhurave** ........ 5
Shënimi 1 – Organizata dhe aktivitetet primare ........ 7
SHËNIMI 2 – Politikat e Kontabilitetit ........ 7
*2.1 Të përgjithshme* ........ 7
*2.2 Baza e përgatitjes* ........ 7
*2.3 NJohja e të hyrave nga kontributet* ........ 8
*2.4 Njohja e shpenzimeve* ........ 8
*2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë* ........ 8
*2.6 Llogaritë e arketueshme dhe pagueshme* ........ 8
SHËNIMI 3 – *Pasuritë fikse* ........ 9
SHËNIMI 4 – çështjet tatimore ........ 10
SHËNIMI 5 – Paraja dhe ekuivalentet e parasë ........ 10
NOTE 6 – Llogaritë e arkëtueshme ........ 10
Shënimi 7 – Detyrimet ........ 11
NOTE 8 – të hyrat e shtyera ........ 11
SHËNIMI 9 – Te hyrat nga donatorët ........ 12
SHENIMI 10 – Shpenzimet e GAP ........ 13

**Instituti për studime të avancuara GAP**

BILANCI I GJENDJES
Më 31 dhjetor 2010

| | *Shënimet* | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|---|
| **PASURITË** | | | | |
| **Pasuritë qarkulluese** | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentet e parasë | 5 | 39,740 | 27,467 | 22,252 |
| Të arketueshmet | 6 | - | 4,678 | 9,682 |
| Parapagimet | | - | - | 350 |
| **Pasuritë jo-qarkulluese** | | | | |
| Pasuritë fikse në vlerën neto në libra | 3 | 8,658 | 10,693 | 11,761 |
| **TOTALI I PASURIVE** | | 48,398 | 42,838 | 44,045 |
| **DETYRIMET DHE BILANCI I FONDEVE** | | | | |
| **Detyrimet afatshkurta** | | | | |
| Detyrimet | 7 | 1,716 | 2,882 | 4,520 |
| Të hyrat e shtyera | 8 | 46,682 | 39,956 | 39,525 |
| **Bilanci i fondeve** | | - | - | - |
| **GJITHSEJT DETYRIME DHE BILANCI I FONDEVE** | | 48,398 | 42,838 | 44,045 |

**Instituti për studime të avancuara GAP**

## PASQYRA E TË ARDHURAVE

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010

| | Shënimet | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|---|
| **Të ardhurat e kontributeve** | | | | |
| Të hyrat nga donatorët | 9 | 159,570 | 228,145 | 187,388 |
| **Total kontributet** | | **159,570** | **228,145** | **187,388** |
| **Shpenzimet** | | | | |
| Programi dhe administrata | 10 | 159,570 | 228,145 | 187,388 |
| Total shpenzime | | **159,570** | **228,145** | **187,388** |
| **Fitimi(humbja) vjetor/e** | | - | - | - |

| | |
|---|---|
| Agron Demi | Nora Latifi |
| Drejtor Ekzekutiv | Drejtor Financiar |

## Instituti për studime të avancuara GAP

Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010

| | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|
| **Fitimi(humbja) vjetore** | - | - | - |
| **Aktivitetet operative:** | | | |
| Zhvlerësimi | 3,017 | 3,408 | 2,940 |
| Zvogëlim(rritje) në të arkëtueshmet | 4,678 | 5,005 | (9,682) |
| Zvogëlim(rritje) në parapagimet | - | 350 | (350) |
| Zvogëlim(rritje) në detyrimet | (1,165) | (1,638) | 4,520 |
| Zvogëlim(rritje) në të hyrat e shtyera | 6,726 | 431 | 39,525 |
| **Neto ndryshimi në para nga aktivitetet operative** | **13,256** | **7,556** | **36,953** |
| **Aktivitetet investuese:** | | | |
| Pagesat për pasuritë fikse | (982) | (2,341) | (14,701) |
| **Neto ndryshimi në para nga aktivitetet investuse dhe financuese** | **(982)** | **(2,341)** | **(14,701)** |
| **Ndryshimi në para dhe ekuivalente të parasë për vitin** | 12,274 | 5,215 | 22,252 |
| Paratë dhe ekuivaltetet e parasë në fillim të vitit | 27,466 | 22,252 | - |
| Paratë dhe ekuivaltetet e parasë në fund të vitit | **39,740** | **27,467** | **22,252** |

## SHËNIMI 1 – ORGANIZATA DHE AKTIVITETET PRIMARE

Instituti për studime të avancuara GAP (prej këtu GAP) është aktiv në Kosovë prej vitit 2007.

Instituti për studime të avancuara GAP është "think tank" dhe ka për qëllim kryesor të tërheq profesionistë duke krijuar hulumtime profesionale dhe mjedise zhvillimore që janë prezente edhe në institucionet e ngjashme në shtetet perendimore. Kjo ju ofron Kosovarëve mundësi të hulumtimeve, zhvillimore dhe të implementimit të projekteve që do të fuqizojnë shoqërinë kosovare. Prioritet për institutin është të mobilizojë profesionistët për adresimin e sfidave të pandërprera ekonomike politike dhe sociale. Objektivat kryesore të GAP janë të krijuara për të lidhur qeverinë dhe njerëzit dhe të lidhur problemet me zgjidhjet.

Më 17 gusht, 2007 GAP është regjistruar në mënyrë zyrtare si një Organizatë Joqeveritare sipas Ligjit No.03/L-134 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

GAP ka të punësuar gjithsejt 11 persona më 31 dhjetor 2010.

## SHËNIMI 2 – POLITIKAT E KONTABILITETIT

*2.1 Të përgjithshme*

Këto pasqyra financiare dhe shënimet përcjellëse janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

*2.2 Baza e përgatitjes*

GAP përgatit pasqyrat financiare sipas kontabilitetit akrual.

Valuta në GAP është Euro (€)

GAP është e obliguar t'i përgatit pasqyrat financiare për qëllime locale pasi që është një entitet ligjor.

*2.3 NJohja e të hyrave nga kontributet*

GAP njeh të hyra deri kur fondet shpenzohen në baza akruale për vlerat e aprovuara buxhetore. Gjithashtu njeh grantet në momentin kur ato pranohen si të hyra të shtyera.

Fondet e shpenzuara gjatë vitit 2010 në baza akruale kanë gjeneruar të hyra kontribuese nga disa contribute të donatorëve.

*2.4 Njohja e shpenzimeve*

Shpenzimet janë të njohura në baza akruale. Në rastet kur një kontratë është nënshkuar apo një grant është dhënë gjatë vitit apo kur një faturë që lidhet me periudhën është pranuar dhe pagesa nuk është kryer para fundit të vitit, shpenzimi është njohur në Bilancin e gjendjes si akrual.

Shpenzimet administrative janë të njohura në periudhën me të cilën ato lidhen.

*2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë*

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato te depozituara në bankat vendore.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë dhe investimet rrjedhëese afatshkurtëra për tre muaj apo më pak prej datës së blerjes dhe i nënshtrohen rreziqeve jo të rëndëesishme për ndryshime në vlerë.

*2.6 Llogaritë e arketueshme dhe pagueshme*

Të arkëtueshme dhe të pagueshmet janë të regjistruara në vlerën e tyre nominale në Euro.

SHËNIMI 3 - *Pasuritë fikse*

GAP përdor metodën e zhvlerësimit drejtvizor, kur një shpenzim e pasurie fikse është e ndarë një vlera të barabarta kundrejt jetës së përdorshme. Shkallët e zhvlerësimit janë si vijon:

| | Shkallët |
|---|---|
| Kompjuterët | 20% |
| Pajisjet e zyres | 20% |
| Pajisjet tjera | 20% |

| | **2010 Euro** |
|---|---|
| **Kostoja** | |
| Bilanci më 01/01/2010 | 14,102 |
| Shtesat | 982 |
| **Bilanci më 31/12/2010** | **15,084** |
| **Zhvlerësimi** | |
| Bilanci më 01/01/2010 | 3,408 |
| Zhvlerësimi për periudhën | 3,017 |
| **Bilanci më 31/12/2010** | **6,425** |
| **Vlera neto në libra më 31/12/2010** | **8,659** |
| **Vlera neto në libra më 31/12/2009** | **10,694** |

## SHËNIMI 4 – ÇËSHTJET TATIMORE

GAP është një organizatë jo profitabile dhe rrjedhimisht nuk i nënshtrohet tatimit në të ardhura.

## SHËNIMI 5 – PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASË

| | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|
| Paraja në PCB | 39,505 | 27,272 | 22,197 |
| Paraja në arkë | 235 | 195 | 55 |
| **Total paraja dhe ekuivalentet e parasë** | **39,740** | **27,467** | **22,252** |

## NOTE 6 – LLOGARITË E ARKËTUESHME

| | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|
| Të arketushme nga donatorët | - | **4,678** | **9,682** |
| CPM (Rishikimi funksional) | - | 2,678 | - |
| IREX | - | 2,000 | - |
| **Total** | - | **4,678** | **9,682** |

## SHËNIMI 7 – DETYRIMET

| | 2010<br>Euro | 2009<br>Euro | 2008<br>Euro |
|---|---|---|---|
| Detyrimet | 1,716 | 2,882 | 4,520 |
| **Total** | **1,716** | **2,882** | **4,520** |

## NOTE 8 – TË HYRAT E SHTYERA

GAP ka pranuar 46,682 Euro si pjesë e të hyrave në të gatshme nga donatorët, e të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2010.

Këto fonde janë njohur si të shtyera nga të hyrat e donatorëve dhe janë zbritur nga të hyrat në të gatshme nga donatorët.

SHËNIMI 9 – TE HYRAT NGA DONATORËT

| **Donatorët** | **2010** Euro | **2009** Euro | **2008** Euro |
|---|---|---|---|
| Corporate & Public Management Consulting Group Ltd. | 5,314 | 83,194 | 35,183 |
| Friedrich Ebert Stiftung (FES) | 3,200 | 3,460 | - |
| Institute for Sustainable Communities (ISC) | 20,645 | - | - |
| National Endowment for Democracy (NED) | 24,409 | 28,372 | - |
| Open Society Institute (OSI) | 37,764 | 36,686 | - |
| Rockefeller Brothers Fund (RBF) | 45,035 | 43,500 | 62,061 |
| The Balkan Trust for Democracy (BTD) | 28,271 | - | 14,985 |
| The International Research and Exchange Board (IREX) | 2,073 | 3,896 | 7,555 |
| UK Department for International Development (DFID) | - | 18,199 | 65,611 |
| USAID | - | 8,270 | - |
| Të tjerë | 898 | 3,000 | 41,518 |
| Të hyra të shtyera 2008 | - | 39,525 | (39,525) |
| Të hyra të shtyera 2009 | 39,956 | (39,956) | - |
| Të hyra të shtyera 2010 | (46,682) | - | - |
| Kthimi i fondeve në NED | (1,314) | - | - |
| **Total** | **159,570** | **228,146** | **187,388** |

SHENIMI 10 – SHPENZIMET E GAP

Shpenzimet e GAP për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010 janë si vijon:

| | **2010**<br>Euro | **2009**<br>Euro | **2008**<br>Euro |
|---|---|---|---|
| Pagat dhe përfitimet | 94,242 | 103,263 | 89,763 |
| Tarifat profesionale | 6,200 | 61,077 | 33,143 |
| Tatimi në të ardhura dhe kontributet | 19,141 | 33,102 | 36,613 |
| Furnizim i zyres | 1,819 | 1,854 | 1,490 |
| Mirëmbjatja e zyres | 155 | 92 | 249 |
| Shpenzime të printimit | 6,881 | 1,045 | 79 |
| Parapagimet | 1,363 | 1,291 | 1,071 |
| Shërbimet komunale | 1,671 | 1,051 | 1,078 |
| Shpenzimet e komunikimit | 4,323 | 2,438 | 2,570 |
| Qiraja dhe tatimi në qira | 14,769 | 10,641 | 11,250 |
| Shpenzimet reprezentative | - | 1,474 | 1,928 |
| Shpenzimet e udhetimit | 622 | 2,573 | 1,385 |
| Shpenzimet e bankës | 466 | 363 | 435 |
| Shërbimet e përkthimit | 310 | - | - |
| Amortizimi | 3,017 | 3,408 | 2,940 |
| Shpenzimet e auditimit | 1,740 | - | - |
| Tjera | 2,851 | 4,470 | 3,394 |
| **Total** | **159,570** | **228,142** | **187,388** |